

Janaq Pani

**BALADË  
PËR NJËMBËDHJETË  
HERONJTË**

poema

81A-1  
P23

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

JANAQ PANI

Redaktor  
ODHISE GRILLO

Piktur  
CLAUDIM ÇEKKA

Baladë  
për  
njëmbëdhjetë  
heronjtë

—  
— Poema —

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

144  
95

BIBLIOTEKA E TIONIMIT

**Redaktor**  
ODHISE GRILLO

JANAO PANI

**Piktor**  
ÇLIRIM CEKA

Balade

per

ni mbledhjet

heronjtë

1958


-Poesma-

BIBLIOTEKA E TIONIMIT



I.  
Baladë për Il heronjtë e Batrës

Il heronjtë e Batrës  
që shpesh shpesh  
në gjatë ditës  
shpesh herë  
në gjatë ditës  
shpesh herë  
në gjatë ditës  
shpesh herë



## Kënga e parë

### I.

Malet dallgëzojnë  
me kreshta të larta,  
në gji kanë thesare,  
përsipër balada.

Ju, male të larta,  
nga përrenjtë e çarë,  
bashkë me të rënët  
plagë keni marrë.


Shtrydhin gjinë malet  
nga gurra në gurrë,  
mëndin trimërinë,  
që nuk shteron kurrë.

Gurrat ligjërojnë  
gjithë mërmërima,  
atje buzët vunë  
me radhë gjithë trimat.

## II.

Kërrusur nga bora malet  
dhe veriu fryn,  
dorë e tij gjëkundi s'ndalet,  
hapësirat ngrin.

Mardhin malet e Kaptinës,  
Dhoksi zbardhëllon,  
pelerinë e bardhë shpinës  
blerimin mbulon.



Por te shkëmb' i Batrës shokët  
sup më sup qëndrojnë,  
thellë nëntokës gjeologët  
mineral kërkojnë.


Dritë merr fytyrë e tyre  
nga djersa pikuar,  
ç'u buron te gurrë e syve  
një dritë e kulluar.

Mbi tufanin skaj më skaj  
sonda uturin,  
hapësirat këngë e saj  
i mbush me gëzim.

Dhe tufani bën çudi:  
«Ç'janë këta vallë,  
ç'zjarr i madh i ngroh në gji  
që më bëjnë ballë?»

Në mes maleve e humbur  
kjo qytezë ngjan  
dhe barakat mbledhur grumbull  
sikur ftohtë kanë.





Porse vijnë e ikin letrat  
me krahë si flutura,  
brenda krahërorit rritin  
ëndrrat më të bukura.

Dhe një ditë në mes shokësh  
vjen një lajm i bardhë:  
Neshat Qokut larg në fshat  
i ka lindur vajzë.





## Kënga e dytë

I.

I vetëm Neshati  
rrugën nis për fshat,  
hapësirë e bardhë  
shtrihet e pamatë.

Ky urim i shokëve  
e ngrohka në gji,  
e bëka me krahë,  
i dhënka fuqi.

Kraharorit thellë  
mbart mall e gëzim,  
cicërimë e parë  
po ia mbush shtëpinë.

Rruga krejt e zënë,  
mbi borë asnjë shteg,  
nuk e kthen Neshatin  
as dhe një ortek.

Petalet e borës  
derdhen si muzikë,  
i ulen mbi supe,  
shkrijnë mbi qerpikë.

Dhe në mot të egër  
gëzimi gjen rrugën,  
vjen të befason  
me gazin e cucës.

## II.

Në krahor të bijën  
e shtrëngon me mall  
dhe rrugën nis prapë  
mes borës mbi mal.

Të kthehet te sonda,  
ku e presin shokët.  
Eh, kjo borë e butë  
si i shtroka flokët!

«Neshat, bir, qëndro!  
Pse nuk rri dhe pak?»  
Sytë e të dashurve  
e ndjekin nga pas...

Në gjoks dashuria  
bën çerdhe gëzimi,  
ndaj vrapon Neshati,  
nuk e tremb thëllimi.

I zgjat dorën kromi  
nga metri në metër,  
ta toki me të  
si dy miq të vjetër.



the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...  
the first...

### III.

Si të lodh kjo bora!  
Rruga është e gjatë,  
hapësirë e bardhë  
është kurth e grackë.

Në shpatet e malit,  
prerë si me thikë,  
vjen i rreptë veriu,  
i rreh me kamxhik.

Thëllim i harbuar  
vërshëllen në bredha,  
shtegu zbret e ngjitet  
me leqe, me dredha.

Rruga zbret e ngjitet,  
po ecën Neshati.  
Përpara ka shokët,  
prapa mbeti fshati.

Shtigjet janë zënë,  
krahët nata shtrin,  
eh, kjo borë e rëndë  
endet si qefin!





Mos duhet të kthehem  
përsëri në fshat?...  
Nga larg vjen një zë:  
«U theve, Neshat?»

Nuk u thye Pali,  
nuk u thye Mrika,  
kush ka besë burri,  
nuk di ç'është frika!»

#### IV.

Dhe ngjitet e ngjitet  
malit fillikat,  
ulurin tufani:  
«Do të ngrij, Neshat!»

Dhe ikën e ikën,  
e me zemër thot':  
«Shokë, ja po vij,  
dimri s'më ndal dot!»

Edhe pak, arrita,  
ia ndiej këngën sondës...  
Ç'borë paska mbledhur  
Zalli i Limonës!

Ç'borë paska mbledhur!  
Kësaj nate sterrë,  
shtegu këtu pret  
drejt përmbi humnerë.

Dritat radhë-radhë  
në fjetore ndrijnë,  
mbi qilim të bardhë  
xixa xixëllijnë.

Xixa xixëllonjat  
po më vijnë pranë,  
si buzëqeshje shokësh,  
të ngrohta më ngjajnë.

Ndaj eci e eci,  
zemra thellë këndon,  
çdo hap e më shumë  
te ju më afron».

## Kënga e tretë

### I.

Bora fare s' resht,  
era fryn e shfryn,  
retë ngjyrë plumbi  
mbi malet i shtyn.

E shtyn tej nga malet  
mjegullën si pritë,  
Neshati s'po duket,  
shkuan pesë ditë.

Tej nga monopati  
u mbeti vështrimi,  
por bora s'ka gojë,  
as edhe thëllimi.

«Alo, Batra, Batra! —  
çirret telefoni —  
Neshati ka mbetur,  
dilni ta kërkon!»

Nga Bulqiza zëri  
nëpër tel vrapon,  
dhembja sot çdo zemër  
si darë e shtrëngon.

Dhembja shtyn e shtyn  
një re shqetësimi,  
nga sytë, te buzët  
të mardh si thëllimi.



## Kënga e katërt

I.

Vjen një çast i hidhur,  
çast i rëndë vjen,  
lart dorashkë e ngrirë,  
shoku poshtë fle.

Një dorashkë leshi  
e mbante Neshati,  
nëna ia kish nisur  
dhuratë nga fshati.

E gdhiu një natë  
shpejt për t'i mbaruar,  
dashurinë e nënës  
si zog mban në duar...

Kjo hapësirë akull  
të ndan sot nga nëna,  
lajmi kur t'i shkojë,  
do t'ia mbajë zemra?

Ja, po zbresin shokët  
lidhur dorë për dorë.  
Eh, se ç'trim na more,  
moj e ftohta borë!

Heshtur te Neshati  
zbresin një nga një,  
era majë Dhoksit  
tufane po ngrë.

## II.

Në kërkim të shokut  
ata malet marrin,  
që të dhjetë tok,  
me shqiponjat ngjanin.

Me supe tufani  
poshtë ortekun nis,  
çfarë gjen përpara,  
e shemb, e vithis.

Ngjeshur borë e akull,  
Dhoks, o mal i sertë,  
rrokullis ortekun  
si një kos e mprehtë.

Dallga zemërake  
lart stërkala ngre,  
thua u shemb mali,  
qielli me re.

Ç'i mbështjell orteku  
që të dhjetë trimat,  
qiellit rendin retë,  
çajné vetëtimat.

### III.

Eh, o mal i Dhoksit,  
ti mal zemërak,  
kosa jote e mprehtë  
sot po kullon gjak.





Dhjetë zemra trimash,  
dhjetë ëndrra vrave,  
buzëqeshje shokësh  
nga gjiri na ndave.

O tufan i egër  
majës së Kaptinës,  
dhjetë goditje thike  
na i dhe pas shpinës.

Mbetën dhjetë shokë,  
dhjetë yje ikën.  
Dhe më lart se malet  
monument u ngritën!

## Kënga e fundit

Kënga ime, dil nga zemra,  
në çdo strofë e në çdo varg,  
lidhur njëmbëdhjetë emra,  
trimërisë iu bën' bajrak!

Hajde, nise rrugën, këngë,  
shko me flatra gjer te retë,  
në furtunë qëndro në këmbë  
si ata të njëmbëdhjetë.

Shko në Batër, në minierë,  
dhe zbrit thellë galerive,  
në çdo hap ke për të ndjerë,  
se ata ndrijnë si yje!



2.

## Autoblinda

*[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page.]*



## Pjesa e parë

I.

Në fshatin tonë,  
kur unë linda,  
pa ftuar erdhi  
autoblinda.

Erdhi nga larg,  
thanë, nga Ruhri,  
troku i luftës  
këtu e pruri.

2.

Nëna tregon:  
«Ti, bir, ahëre  
te guvë e thellë  
me britma erdhe.

Armiku i egër  
po qasej, — thanë. —  
Urrejtja ndezi  
prush sytë tanë.

Dhe lamë fshatin,  
u ngjitëm la,  
në mal, në shpella  
fëmijë e gra.

Ish vjeshtë e dytë,  
shiu rigonte,  
tavan i gurtë  
mbi ne pikonte.

Dhe gjurmë linin  
pikat mbi shkëmb,  
por nëna kishte  
gëzimin tënd.





Të akullt muret,  
shpella pikonte,  
por brenda zemrës  
një shpresë ngrohte.

3.

Në instikame,  
te kthesë e rrugës,  
të vrenjtur rrinë  
njerëzit dhe gurët.

Të vrenjtur rrinë,  
vesh mbajnë detin,  
dallgët si mal  
urrejtjen vjellin.

Dhe pulëbardhat  
rrugës tek ikin,  
alarm beteje  
veç klithin, klithin.

Mbi heshtjen mal,  
tej zhurmërimës,  
afrohet hija  
e autoblindës.



Dhe në çdo zemër  
ngre dufe kënga:  
«S'na trembën kurrë  
armët e rënda!»

4.

Dhe ngjishen retë  
në majëmalet,  
nga zbret kolona,  
që s'do të ndalet.

Si një përbindësh  
kthetrat i shtrin,  
dhe mitralozin  
e vringëllin.

Kjo fjala «Alt!»  
si thikë pret,  
me gjuhë plumbash  
godet, godet.

Autoblinda  
në ballë prin  
e mali vrëret,  
e deti nxin.

Me ngjyrë vdekjeje  
e tëra lyer,  
në ballë e shpinë  
kryqin e thyer.

5.

Ky breg mbi shpinë  
s'mund të të mbajë,  
«Ndal, kryq i thyer,  
qëndro, murtajë!»

Te trimëria  
vë buzët kënga:  
«S'na trembin kurrë  
armët e rënda!»

Më tregon nëna:  
ditën kur linda,  
në flakë u ndez  
autoblinda.



de l'année dernière  
et les années  
passées.

E turravrap  
mes flakësh rendi,  
humbi mes dallgësh  
te ky gji deti.

U gremis poshtë  
dhe kryq i thyer,  
me ngjyrë vdekjeje  
i tëri lyer.

Deti u rrudh  
gjithë zemërim,  
tallaze ngriti  
mbi autobлиндë.

6.

Me qumësht bashkë  
më mëndi nëna  
gjithë zemërimin  
që i vlonte brenda.

Tek përkëdhelte  
doçkat e birit,  
një dritë e ëmbël  
i fekste syrit.

E dritë merrnin  
muret e rënda,  
nga buzë e bukur  
buronte kënga.







## Pjesa e dytë

7.

Te ky gji deti,  
mes dallgësh humbur,  
autoblinda  
qëndron e strukur.

Sa shumë vite  
qëndroi në heshtje,  
me gojën kyçur  
si një memece.

E vijnë dallgët,  
përplasen rreptë,  
e mitralozi  
zgjatet pa jetë.


Atje në kodër,  
ku rritet bari,  
ngrihet i bardhë  
sot lapidari.

Aty mësojnë  
brezat që vijnë,  
si të rrëzuar,  
autoblindë.

8.

Flamur fitoret  
shpalosin vitet,  
pas çdo beteje  
atdheu rritet.

Filiz Partie  
u rrita unë,  
udhët e tua  
ku nuk më shpunë.



Dalla götini  
vjen me mpash avto:  
-Ty iu porasin.  
dit jartstet!

Por përsëri  
kthehem në fshat,  
e shkoj e rri  
te guva lart.


Përpara detin,  
pas shpine malin,  
e nis bisedën  
shtruar me djalim...

9.

Mes dallgësh djali  
çan vrik me not  
e shkon e ulet  
mbi mitraloz

Një dritë e bukur  
i shkrepi në sy,  
e brigjet marrin  
shkëlqim të ri.

Dallgë gëzimi  
vjen më mbush sytë:  
«Ty të përkasin,  
bir, lartësitë!»



nje die vere

IT. autophobe  
Kernde rabe  
mes hallish fuphur  
pödlie u wete

Dhe të më rritesh  
lastar i blentë,  
veç ballë armikut  
qëndro i sertë.

E sheh, në vite  
kjo mbeti lodër,  
kur lapidari  
ndriçon mbi kodër.

E lartësohet  
i bardhë borë,  
rrënjët i ka  
te çdo dëshmor.

## 10.

Te ky gji deti,  
perlë riviere,  
ndalën ca njerëz  
një ditë vere.

Ti, autobлиндë,  
gërmuqe mbete,  
mes dallgësh humbur  
përditë u trete.

Humbur mes ujit  
zhytur në rërë,  
mbete kështu  
vite të tërë.

Myshku ka veshur  
trupin e hekurt,  
qeshin fëmijët:  
«Shiko seç mjekër!»

11.

Te kjo kështjellë  
e lashtë shumë,  
autoblindë,  
dhe ty të prunë.

Ti e vetmuar  
mënjë hiqesh,  
mbi trupin tënd  
fragmente kryqesh.

Trupa pa jetë  
ju jeni sot,  
kryqe të thyer,  
gjarpër pa kokë.



Handwritten text, likely bleed-through from the reverse side of the page. The text is mirrored and difficult to decipher but appears to contain several lines of a letter or document.



Dhe vij me djalin  
në muzeum,  
për ngjarje lufte  
i kallëzoj unë.

Një babagjysh  
tek na dëgjon,  
tregimit tim  
diçka i shton...

Dorën na hedh  
mua e djalit  
e dritë i marrin  
dy sytë e ballit.

Kështu të tre  
jemi në këmbë  
për ty, atdhe,  
për tokën mëmë.

PËRMBAJTJA

	Faqe
1. BALADË PËR 11 HERONJTË E BATRËS .....	3
2. AUTOBLINDA .....	29



Pani, J.

Baladë për njëmbëdhjetë heronjtë.  
Poema. [Red.: O. Grillo. Pikt. Ç.  
Ceka]. T., «Naim Frashëri», 1984.

52 f. me il. (Bibliot. e Pionierit)

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983 - 93 - 1

P 23

Tirazhi: 2 000 kopje

Format: 70x100/32

Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1984